




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetjen të nenit 7 paragrafit 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, në mbledhjen e mbajtur më datën 10 shkurt 2022,

Miraton:

RREGULLORE NR. 02/2022

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.07/2019 PËR CERTIFIKIMIN E INTERPRETËVE DHE PËRKTHYESVE GJYQËSOR

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 07/2019 për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor.

Neni 2

1. Neni 3 paragrafi 1 i Rregullores bazë, para nën paragrafit 1.1. shtohen nënparagrafe të reja si në vijim:

- 1.1. **Ligji** – Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2. **KGJK** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.3. **Komisioni për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidatëve** - komisionin

e themeluar nga Këshilli, përgjegjës për zhvillimin e procedurave për certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor;

1.4. **Anëtarë i Komisionit** - anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë Rregullore;

1.5. **Anëtarë rezervë i Komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit apo raste të tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtarë.

2. Pas përfshirjes së nën paragrafëve të ri ndryshohet renditja e nën paragrafëve në rregulloren bazë, ashtu që ri listohet radhitja numerike e nën paragrafëve të tjerë në këtë nen.

Neni 3

Neni 6 i rregullores bazë riformulohet si në vijim:

Neni 6

Aplikacioni për certifikim

1. Aplikacioni për certifikim i dorëzohet KGJK-së, sipas formularit të hartuar nga Sekretariati i KGJK-së, duke ia bashkëngjitur dokumentet e vërtetuara me të cilat dëshmon se i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 5 të Rregullores bazë.

2. Aplikacioni i kandidatit duhet të jetë i qartë nëse kërkon të certifikohet si përkthyes gjyqësor apo si përkthyes dhe interpret gjyqësor.

3. Kandidati në aplikacion cakton çiftin e gjuhëve për të cilën kërkon të certifikohet.

4. Kandidati mund të aplikojë për certifikim për më shumë se një çift gjuhësh.

5. Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si përkthyes apo interpret gjyqësor për një çift gjuhësh duhet të paguajë taksën prej pesëdhjetë (50) euro, e cila pagesë duhet të dorëzohet bashkë me aplikacionin.

6. Kandidati i cili certifikohet si përkthyes gjyqësor obligohet ta paguajë taksën shtesë prej njëqind (100) euro, ndërsa kandidati i cili certifikohet si përkthyes dhe interpret gjyqësor për një çift gjuhësh paguan taksën prej njëqind e pesëdhjetë (150) euro. Kjo pagesë duhet të bëhet brenda 7 ditësh, nga shpallja e listës së kandidatëve në faqen zyrtare e KGJK-së.

7. Kandidatët që nuk i kryejnë obligimet sipas paragrafit 5 dhe 6 konsiderohen që kanë hequr dorë nga aplikimi, respektivisht certifikimi.

Neni 4

Neni 8 i rregullores bazë riformulohet si në vijim:

Neni 8 Komisioni

1. Këshilli themelon Komisionin për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidateve për certifikim të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor, në bazë të kriterëve të përcaktuara me Ligjin, Rregulloren Nr. 03/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe me këtë rregullore.

2. Komisioni për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidateve për certifikim të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor përbëhet nga tre (3) anëtarë të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezervë, të cilët zgjidhen me mandat katër (4) vite, pa mundësi të riemërimit. Këshilli zgjedh kryetarin e komisionit nga radhët e anëtarëve të rregullt të këtij komisioni.

3. Për t'u emëruar anëtarë i Komisionit për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidatëve për certifikim të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor duhet të plotësohen njëri nga kriteret si në vijim:

- 3.1. të jetë profesionist, apo të ketë ushtruar punën e përkthyesit në çiftin e gjuhëve jo më pak se pesë (5) vjet;
- 3.2. të ushtojë profesionin e profesorit të gjuhës në të cilën kërkohet certifikimi jo më pak se pesë (5) vjet;
- 3.3. juristi apo gjyqtari, i cili caktohet anëtar i komisionit, duhet të jetë njohës i çiftit të gjuhëve për të cilat mbahet provimi;
- 3.4. të jetë përfaqësues i organizatave ndërkombëtare të cilat ofrojnë kurse në gjuhën përkatëse; si dhe,
- 3.5. përjashtimisht nën paragrafit 3.1 dhe 3.2, në rast se paraqitet nevoja për certifikim të përkthyesit apo interpretit të çiftit të gjuhës me kuadro deficitar, Këshilli mund të emëroj për anëtarë të komisionit edhe profesionistët me përvojë pune me më pak se pesë (5) vite.

4. Anëtari i Komisioni për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidatëve duhet të ketë njohuri për çiftin e gjuhëve të nivelit që mundëson vlerësimin e kandidatit në atë çift gjuhësh.

5. Komisioni për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidatëve është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës së certifikimit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor, për hartimin (formulimin e pyetjeve) e provimit me shkrim dhe me gojë, vlerësimin, përpilimin dhe dërgimin e listës përfundimtare të kandidatëve të certifikuar në Këshill.

5.1. Pyetjet e parashtruara në provim janë konfidenciale dhe nuk guxojnë të ndahen me askënd jashtë Komisionit.

5.2. Ndarja e testeve me persona jashtë Komisionit paraqet bazë për mos pagesë së punës së bërë në Komision si dhe bazë për t'u larguar nga Komisioni.

6. Komisioni mbështetet nga sekretari i komisionit, që njëherit është Udhëheqës i Zyrës së Përkthimeve të Sekretariatit të KGJK-së. Në rrethana të jashtëzakonshme, KGJK mund të caktojë një person tjetër për sekretar të komisionit.

7. Anëtarët e Komisionit kompensohen për punën e tyre. Skema e kompensimit përcaktohet nga Këshilli.

Neni 5

Neni 16 i rregullores bazë riformulohet si në vijim:

Neni 16

Kartela identifikuese dhe vula

1. Çdo interpret dhe përkthyes gjyqësor duhet të ketë kartelë identifikuese dhe vulë. Format i kartelës dhe vulës përcaktohet nga KGJK-ja.

2. Kartela e përkthyesit / interpretit lëshohet nga KGJK dhe duhet të përmbajë:

2.1. logon e institucionit që e certifikon;

2.2. numrin e certifikatës;

2.3. emrin dhe mbiemrin;

2.4. foton; dhe

2.5. çiftin e gjuhëve për të cilën është certifikuar.

3. Vula duhet të jetë për çiftin e gjuhëve për të cilën është certifikuar.

4. Vula e cekur në paragrafin e mësipërm duhet të jetë e rrumbullakët, me diametër 40 mm, në të cilën duhet të shënohet:

- 4.1. në rrethin e parë: Republika e Kosovës / Republika Kosovo;
- 4.2. në rrethin e dytë: përkthyes apo përkthyes dhe interpret gjyqësor;
- 4.3. në rrethin e tretë: emri dhe mbiemri i interpretit / përkthyesit; dhe
- 4.4. në rrethin e katërt: çiftin e gjuhëve për të cilën është i certifikuar.

4. Shpenzimet për pajisje me vulë i bartë vetë përkthyesi / interpreti gjyqësor.

6. Interpreti / përkthyesi duhet ta deponojë nënshkrimin dhe kopjen e vulës në KGJK. Përshtatshmërisht kur të krijohen kushtet, përkthyesit dhe interpretët mund të deponojnë nënshkrimin dhe vulën elektronike.

7. Përmbajtja e tekstit standard që vërteton saktësinë e përkthimit sigurohet nga KGJK-ja për të gjithë përkthyesit dhe interpretet gjyqësorë të certifikuar.

Neni 6

Neni 20, paragrafi 2 i rregullores bazë riformulohet si në vijim:

Neni 20 Skema e Kompensimit

2. Për interpretimin nga një gjuhë në gjuhë tjetër:

- 2.1. për orën e filluar - 15.00€ (deri në 30 minuta), duke llogaritur kohën e humbur për të ardhur dhe kthyer në vendin ku është kërkuar përkthimi.
- 2.2. për një orë intepretimi - 25.00€, përfshirë kohën e pauzës.

Neni 7

Neni 23, i rregullores bazë riformulohet si në vijim:

Neni 23 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Pas certifikimit të përkthyesve / interpretëve të rinj, KGJK përmes njoftimit publik fton të gjithë përkthyesit dhe interpretët e certifikuar me aktvendim nga ish Gjykatat e Qarkut, që në afat prej

një (1) viti, të paraqiten në KGJK, për përfshirjen e tyre në listën e re të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë.

2. Përkthyesit dhe interpretet gjyqësor të certifikuar me aktvendim nga ish Gjykatat e Qarkut, të cilët në KGJK aplikojnë për përfshirjen e tyre në listën e re të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor, duhet të prezantojnë dokumentet si në vijim:

- 2.1. dokumentin identifikues;
- 2.2. aktvendimin e ish Gjykatës së Qarkut për licencim, në origjinal apo kopje të vërtetuar;
- 2.3. certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata;
- 2.4. certifikatën shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike;

3. KGJK, themelon një Komision ad hoc për verifikimin e dokumentacionit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor të certifikuar më parë me aktvendime nga ish Gjykatat e Qarkut.

4. Nëse përkthyesit dhe interpretët gjyqësor nuk aplikojnë për përfshirje në listën e re të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor brenda afatit kohor të përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni, konsiderohet se të njëjtit nuk janë të licencuar dhe për certifikim të sërishëm duhet t'i nënshtrohen procedurave sipas rregullores bazë pa asnjë përjashtim.

5. Përkthyesit me aktvendime nga ish Gjykatat e Qarkut janë të obliguar të pajisen me certifikatë dhe kartelë siç parashihet me rregullore.

6. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen Rregullorja nr.16/2015 për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësorë dhe Rregullorja Nr. 16/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.16/2015 për Emërimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësorë.

Neni 8

Pas nenit 23 shtohet një nen i ri si në vijim:

Neni 23 A

Shtojcat e Rregullores


1. Shtojcat që i janë bashkangjitur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse të saj:

- 1.2. aplikacioni për certifikim;
- 1.3. formulari për vlerësim nga anëtari i komisionit të provimit me shkrim për përkthyes

- dhe interpret gjyqësor;
- 1.4. formulari i vlerësimit nga komisioni i provimit me shkrim për përkthyes dhe interpret gjyqësor;
 - 1.5. formulari për vlerësim nga anëtari i komisionit të provimit me gojë për përkthyes dhe interpret gjyqësor;
 - 1.6. formulari i vlerësimit nga komisioni i provimit me gojë për përkthyes dhe interpret gjyqësor;
 - 1.7. certifikata;
 - 1.8. kartela identifikuese; dhe,
 - 1.9. formulari që e vërteton saktësinë e përmbajtjes së tekstit standard.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 15.02.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

APLIKACIONI PER CERTIFIKIM
APLIKACIJA ZA LICENCIRANJE

1. TË DHËNAT PERSONALE/LIÇNI PODACI

| | |
|-------------------------------|--|
| EMRI/IME | |
| MBIEMRI/PREZIME | |
| DATA E LINDJES/DATUM ROĐENJA | |
| VENDI I LINDJES/MESTO ROĐENJA | |
| NËNSHTETËSIA/DRŽAVLJANSTVO | |

2. GJUHA E JUAJ AMTARE/VAŠ MATERNJI JEZIK _____
3. ÇIFTI I GJUHËVE PËR TË CILËN APLIKONI/PAR JEZIKA ZA KOJI SE PRIJAVLUJETE _____
4. JU LUTEM SHËNONI ME SHENJËN , SE A APLIKONI VETËM PËR PËRKTHYES GJYQËSOR APO PËR PËRKTHYES DHE INTERPRET GJYQËSOR./MOLIMO VAS ŠTIKLIRAJTE ZNAKOM DA LI SE PRIJAVLUJETE SAMO ZA SUDSKOG PREVODIOCA ILI ZA SUDSKOG PREVODIOCA I TUMAČA

| | |
|---|--|
| VETËM PËR PËRKTHYES GJYQËSOR/SAMO ZA SUDSKOG PREVODIOCA | |
| PËR PËRKTHYES DHE INTERPRETË GJYQËSOR/ ZA SUDSKOG PREVODIOCA I TUMAČA | |

5. KUALIFIKIMI PROFESIONAL (JU LUTEMI TË BASHKËLIDHNI FOTOKOPJE TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE) STRUČNA SPREMA (MOLIMO VAS PRILOŽITE FOTOKOPIJU DIPLOME I SERTIFIKATE ILI UVERENJA)

| EMRI I INSTITUCIONIT ARSIMOR NAZIV OBRAZOVNE INSTITUCIJE | VITET (PREJ – DERI) GODINE (OD –DO) | CERTIFIKATA DHE/OSE DIPLOMA PËR KUALIFIKIMET E KRYERA/SERTIFIKATI ILI DIPLOMA O KVALIFIKACIJA |
|---|--|--|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

6. PËRVOJA E PUNËS/RADNO ISKUSTVO

| INSTITUCIONI / ORGANIZATA INSTITUCIJA /ORGANIZACIJA | POZITA/POZICIJA | PREJ – DERI/OD – DO |
|--|-----------------|---------------------|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

7. TRAJNIME DHE KUALIFIKIME TJERA/OSTALA OBUKA I KVALIFIKACIJE

| EMRI I INSTITUCIONIT NAZIV INSTITUCIJE | KURSI I NDJEKUR NUMRI I MUAJVE/ VITET POHAÐANA OBUKA, BROJ MESECI ILI GODINA | CERTIFIKATAT DHE/OSE DIPLOMAT PËR KUALIFIKIMET E KRYERA SERTIFIKATI ILI DIPLOME O KVALIFIKACIJI |
|---|---|--|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

Unë, i poshtënjshkruari, deklaroj që informacioni i dhënë më sipër është, me sa di unë, i vërtetë dhe i plotë.

Jam në dijeni se dokumentet e mëposhtme mbështetëse janë të nevojshme për kualifikimin e aplikimit tim dhe unë marr përsipër të paraqes dokumentet mbështetëse siç kërkohen dhe jam në dijeni se mos dërgimi i këtyre dokumenteve mund të çojë në diskualifikimin apo mos vlerësimin e kërkesës sime.

Ja dole potpisanë, izjavljujem da su napred navedeni podaci, prema mom znanju, verodostojni i potpuni.

Svestan sam da su dole priloženi dokumenti neophodni za kvalifikaciju mog apliciranja, i ja preuzimam odgovornost da priložim dokumente prema zahtevu, i svestan sam da ne neprilaganje istih može do dovođe do diskvalifikacije ili do nerazmatranja moje prijave.

- a. Diplomën universitare të vlefshme në Republikën e Kosovës; Važeću UniverzitetSKU diplomu Republike Kosova
- b. Dëshmi për përvojën e punës/ Dokaz o radnom iskustvu
- c. Certifikata e nënshtetësisë/ Uverenje o državljanstvu
- d. Certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata; Uverenje iz kaznene evidencije izdate iz suda
- e. Certifikatën shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike; dhe: Zdravstveno uverenje o ocenjivanju pshifizičkog stanja: i
- f. Dëshminë për pagesën/ Uverenje o isplati

(Nënshkrimi/potpis)

(vendi dhe data/mesto i datum)

Ju lutemi:

Sigurohuni që e keni mbushur formularin. Të gjitha pyetjet kanë nevojë për përgjigje – shënoni N/A për çdo seksion që nuk lidhet me ju.

Dorëzoni formularin së bashku me dokumentacionin e kërkuar tek: Këshilli i Gjyqësor i Kosovës, Rr. Luan Haradinaj nr.133, Prishtinë, Kosovë.

Kërkesat dhe formularët nuk do tu kthehen kandidatëve.

Molimo vas da popunite obrazac na pravilan način i to proverite. Odgovarite na sva pitanja. Upišite N/A na sva pitanja koja ne važe za vas.

Obrazac uz priložene dokumente podnestite u Sudskom savetu Kosova, ul. Luan Haradinaj, br.133, Priština, Kosovo.

Obrasci prijave se ne vraćaju kandidatima.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**FORMULAR PËR VLERËSIM NGA ANËTARI I KOMISIONIT TË PROVIMIT ME
SHKRIM PËR PËRKTHYES DHE INTERPRET GJYQËSOR
OBRAZAC ZA OCENJIVANJE PISMENOG ISPITA OD ČLANA KOMISIJE ZA
SUDSKOG PREVODILACA I TUMACA**

Kodi: _____
Kod: _____

Data: _____
Datum: _____

| Kriteri / Kriterijum | Pikët Maximale / Maksimalni bodovi | Vlerësimi i anëtarit të Komisionit / Ocenjivanje člana komisije |
|--|---|--|
| Përkthimi nga gjuha A. në gjuhën B / Prevod sa jezika A na jezik B. | 35 | |
| Përkthimi nga gjuha B. në gjuhën A / Prevod sa jezika B na jezik A | 35 | |
| Njohja e terminologjisë juridike / Poznavanje pravne terminogije | 30 | |
| Totali i pikëve Ukupan broj bodova | 100 | |

Komenti i Vlerësuesit:
Komentar ocenjivača:

Anëtar i komisionit/vlerësuesi: _____
Član komisije/ocenjivač:

Nënshkrimi: _____
Potpis:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

FORMULAR I VLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PROVIMIT ME SHKRIM PËR PËRKTHYES
DHE INTERPRET GJYQËSOR
OBRAZAC ZA OCENJIVANJE OD KOMISIJE PISMENOG ISPITA ZA PREVODIOCE I SUDSKE
TUMAČE

Kodi: _____
Kod: _____

Datë: _____
Datum: _____

| Vlerësimi sipas kriterëve | Komisioni / komisija | | | Rezultati mesatar / proseçni rezultat |
|---|--|--|--|---------------------------------------|
| | Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivjanje Çlana | Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivjanje Çlana | Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivjanje Çlana | |
| I. Përkthimi nga gjuha A në B (max.35 pikë) Prevod sa jezika A na B (max 35 boda) | | | | |
| II.Përkthimi nga gjuha B në A (max. 35 pikë) Prevod sa jezika B na jezik A (max 30 boda) | | | | |
| III.Njohja e terminologjise juridike (max.30) Poznavanje pravne terminologije | | | | |
| Totali i pikëve të arritura (I+II+III- Ukupan broj postignutih bodova | | | | |
| Pikët maximale që mund të arrihen Maksimalni broj bodova koji se može postići | 100 | | | |
| Kalueshmëria Prolaznost | 70 | | | |

| Komisioni / Komisija | Emri dhe mbiemri / Ime i prezime | Nënshkrimi / Potpis |
|---|----------------------------------|---------------------|
| Kryetari i Komisionit / Predsednik Komisije | | |
| Anëtar i Komisionit / Çlan Komisije | | |
| Anëtar i Komisionit / Çlan Komisije | | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

FORMULAR PËR VLERËSIM NGA ANËTARI I KOMISIONIT TË PROVIMIT ME
GOJË PËR PËRKTHYES DHE INTERPRET GJYQËSOR
OBRAZAC OCENJIVANJE USMENOG ISPITA OD ČLANA KOMISIJE KANDIDATA
ZA SUDSKOG PREVODILACA I TUMAČA

Emri i kandidatit: _____
Ime kandidata: _____

Data: _____
Datum: _____

| Çifti i gjuhëve / Jezički par | Pikët Maksimale / Maksimalni bodovi | Vlerësimi i anëtarit të Komisionit / <i>Ocenjivanje člana komisije</i> | Kalueshmëria <i>Prolaznost</i> |
|----------------------------------|--|--|-----------------------------------|
| | 100 | | 70 |

Komenti i Vlerësuesit:
Komentar ocenjivača:

Anëtar i komisionit/vlerësuesi: _____
Çlan komisije/ocenjivač: _____

Nënshkrimi: _____
Potpis: _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

FORMULAR I VLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PROVIMIT ME GOJË PËR PËRKTHYES
DHE INTERPRET GJYQËSOR
OBRAZAC OCENJIVANJA USMENOG ISPITA ZA SUDSKE TUMAČE I PREVODIOCE

Kandidati _____

Kandidat:

Data: _____

Datum:

| Pikët maksimale / Maksimalni bodovi | Pragu i kalueshmërisë / Prag prolaznosti | Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivanje Člana | Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivanje Člana | Vlerësimi i anëtarit/ Ocenjivanje Člana | Totali / Ukupno |
|--|--|--|--|--|--------------------|
| 100 | 70 | | | | |

| Komisioni / Komisija | Emri dhe mbiemri / Ime i prezime | Nënshkrimi / Potpis |
|--|----------------------------------|---------------------|
| Kryetari i Komisionit / Predsednik Komisije | | |
| Anëtar i Komisionit / Član Komisije | | |
| Anëtar i Komisionit / Član Komisije | | |



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Certifikatë / Sertifikat / Certificate
Nr./Br./No. Shqip / serb. 001

EMRI – IME (EMRI I PRINDIT-IME RODITELJA) MBIEMRI - PREZIME

Ka përfunduar me sukses provimin dhe është certifikuar për/Uspešno je položio ispit i sertifikuje se za
/Has successfully completed the exam and is certified for

PËRKTHYES DHE INTERPRET GJYQËSOR PËR ÇIFTIN E GJUHËS
SUDESKI PREVODILAC I TUMAÇ ZA JEZIČKI PAR / COURT TRANSLATOR/INTERPRETER FOR THE LANGUAGE PAIR

Në Prishtinë, më/ U Prištini, dana /
In Prishtina, on _____

Albert Zogaj
Kryesues/Predsedavajući/Chair
Këshilli Gjyqësor i Kosovës/ Sudski savet Kosova/ Kosovo Judicial Council

KARTELA IDENTIFIKUESE/ IDENTIFIKACIONA KARTICA/IDENTIFICATION CARD

pjesa e përpara/ prednji deo/ front side



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQESOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVA JUDICIAL COUNCIL

KARTELË IDENTIFIKUESE / IDENTIFIKACIONA KARTICA
/IDENTIFICATION CARD

PËRKTHYES/INTERPRET GJYQËSOR
SUDSKI TUMAÇ/PREVODILAC
COURT TRANSLATOR/INTERPRETER

Nr.i Cert. /Broj sert. /No. of Cert.

(Gjuhët-Jezici – Languages)

EMRI /IME/NAME:

MBIEMRI/PREZIME/SURNAME:

foto

Faqja e parë
Teksti
Prva stranica
Tekst

Faqja e fundit
Teksti
Zadnja stranica
Tekst

*Unë, _____, përkthyes/ interpret i certifikuar me nr. Cert. 001, me këtë vërtetohet që ky është përkthim i saktë dhe i përpiktë i dokumentit. Nr. i protokolit. 123
Tel: +383 (0) 38 123 456, E-mail adresa: xyz@abc.com*

*Ja, _____, prevodilac/tumač sertifikovan sa sertifikatom br. Cert. 001, ovim potvrđujem da je ovo tačan i precizan prevod dokumenta. Br. protokola. 123
Tel: +383 (0) 38 123 456, E-mail adresa: xyz@abc.com*

Vula dhe nënshkrimi
Peçat i potpis